

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mijëra protestojnë në Sinaloa kundër dhunës së kartelit të drogës: Duam paqe
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/mijera-protestojne-ne-sinaloa-kunder-dhunes-se-kartelit-te-s-duam-paqe-i585944
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 07:44:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 08:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	84844af3e92b149e2bd19136359e13e531448ef85cb549acf3dcf9a59fc0773e
TEKSTI	b0492f3fc5efb8d6de3a3f8ed0c5f35a7cc1807e92a9c67273de10efc4fcf9d3
PAMJA	57b924cc0aad5a69d66b95b2d1fa3fd2340d5328840cff1c6ee155747ef7abea

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	440b2c45246d720ed5799e2a399a52917d7437435b1d1cf60717342cd77478fb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/440b2c45246d720ed5799e2a399a52917d7437435b1d1cf60717342cd77478fb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie [Protestuesit tentojnë të bllokojnë rrugën tek "Zogu i Zi", policia nderhyn dhe shoqeron disa persona"Kush hton në Aj, hton"/ "Trump refuzon ngadalesimin e zhvillimit: Nu fundit](#)

Mijëra protestojnë në Sinaloa kundër dhunës së kartelit të drogës: Duam paqe

TemA

14 Shtator 2026, 10:30Bota TEMA



Mijëra njerëz dolën të dielën në rrugët e shtetit Sinaloa, në veriperëndim të Meksikës, për të protestuar kundër dhunës së shkaktuar nga konflikti i brendshëm brenda kartelit të fuqishëm të drogës Sinaloa.

Të veshur me të bardha dhe duke mbajtur pankarta me mesazhe për paqe, rreth 10 mijë demonstrues marshuan drejt katedrales së Culiacánit, kryeqytetit të shtetit. Protesta u organizua me mbështetjen e Kishës Katolike, komunitetit të biznesit dhe familjeve të viktimave të dhunës.

"Jemi të lodhur duke jetuar me frikë. Duam paqe", ishte një nga mesazhet kryesore të protestuesve. Gjatë tubimit, dhjetëra tullumbace të bardha u lëshuan në qiell në shenjë paqeje dhe kujtimi për viktimat.

Mes protestuesve ishte edhe Maricela Perez, 62 vjeç, e cila mbante portretin e djalit të saj 36-vjeçar, Miguel, i vrarë në maj pasi u qëllua me armë zjarri në një fushë voleybolli.

Kryepeshkopi i Culiacánit, Jesus Jose Herrera, u bëri thirrje grupeve kriminale t'i japin fund dhunës. "Asnjë territor dhe asnjë ambicie nuk vlen më shumë se një jetë njerëzore", deklaroi ai.

Karteli Sinaloa, një nga organizatat kriminale më të fuqishme të Meksikës, është përfshirë prej kohësh në një konflikt të ashpër të brendshëm. Organizata u themelua në vitet 1980 dhe lidhet me emra të njohur të trafikut të drogës, përfshirë Joaquín "El Chapo" Guzmán dhe Ismael "El Mayo" Zambada.

"El Chapo" u arrestua në vitin 2016 dhe më pas u ekstradua në Shtetet e Bashkuara, ku po vuan një dënim të përjetshëm. Pas përplasjeve dhe ndryshimeve në udhëheqjen e kartelit, rivalitetet mes fraksioneve kanë shkaktuar një valë të re dhune në Sinaloa, duke rritur frikën dhe pasigurinë tek banorët.

Protestuesit kërkuar që autoritetet dhe grupet kriminale të ndalojnë ciklin e dhunës dhe që familjet e viktimave të mos përballen më me humbje të tjera.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

["Kush fiton në AI, fiton"/ Trump refuzon ngadalësimin e zhvillimit: Nuk mund t'ia lëmë avantazhin Kinës](#)

09:40 Bota

Zelenskyy u kërkon ligjvënësve të mbështesin shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm

09:20 Bota

Negociata të reja SHBA-Rusi-Ukrainë? Kremlin: Nuk e përjashtojmë një mundësi të tillë

08:30 Bota

AfD kërcënim për Kosovën, anulim njohja e pavarësisë? Deputeti Teich sqaron deklaratat

08:00 Bota / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.